

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Qeveria prezanton me ndërtuesit skemën e re për pallatet: 30% e apartamenteve do të jenë për strehim social, 40% për shtresën e mesme dhe 30% për tregun e lirë
ADRESA	https://newsbomb.al/ekonomi/qeveria-prezanton-me-ndertuesit-skemen-e-re-per-pallatet-30-e-apartament-i401822
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:43:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 12:59:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4725f6c9e14a0b19fefc1d542e55e19b6c9c976f4cbf0a5ce636013dce08f44f
TEKSTI	adeb912afa5495ea4e21b4d674a5fa41f450eecd83092420a8856674f2c45ca1
PAMJA	c36aaf26e5a3d2af69f8b678e8b383c742db298058ed84f14187fd769739aab8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a08c5d69046dbe195afdbd9c562bd5e1100345bab6a59bee9f5b1aadd84312a1
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a08c5d69046dbe195afdbd9c562bd5e1100345bab6a59bee9f5b1aadd84312a1>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Ekonomi

22 Shtator 2026, 14:59

Qeveria prezanton me ndërtuesit skemën e re për pallatet: 30% e apartamenteve do të jenë për strehim social, 40% për shtresën e mesme dhe 30% për tregun e lirë

Shkruar nga Newsbomb



Ministrja e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, zhvilloi një takim me përfaqësues të Shoqatës së Ndërtuesve dhe përfaqësues të tregut imobiliar, në kuadër të punës për reformimin e politikave të strehimit dhe zgjerimin e skemave të strehimit të përballueshëm.

Në vijim të reformës, Ibrahimaj bëri të ditur se nga viti i ardhshëm parashikohet edhe një model i ri ndërtimi me përdorim të përzier, ku 30% e banesave do të jenë për strehim social, 40% për strehim të përballueshëm për shtresën e mesme dhe 30% për tregun e lirë. Ky model synon të krijojë një përzierje të kategorive të ndryshme të banimit, duke shmangur përqendrimin e një kategorie të vetme sociale në të njëjtat ndërtesa dhe lagje.

Ministrja Ibrahimaj u shpreh se ndryshimi i politikave të strehimit lidhet me nevojën për t'iu përgjigjur zhvillimeve të tregut dhe rritjes së çmimeve, veçanërisht në qytetet kryesore të vendit. Sipas saj, politika e re synon të shtrihet përtej kategorive në nevojë, duke përfshirë edhe shtresa të tjera që hasin vështirësi në përballimin e kostove të

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Aktualitet

FRANGOSET në Rusi trafikanti i shumëkërkuar i SPAK Shpëtim Allu, "shoku" i Eldi Dizdanti pritët t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)



Politikë

"Shteti i gysrave!" Sallanji "shpërthen" pas arrestimit të shefes së SHISH: Qeveria e Ramës ka ulur pantollonat para kirit (REAGIMI)

Zbulu më shumë artikuj >

"Ky ndryshim vjen qoftë si pasojë e nevojës që tregu ka, qoftë si pasojë e rritjes së çmimeve, kryesisht në qytetet kryesore të vendit, në qendrat e qyteteve kryesore të vendit, por edhe bazuar në gjithë modelet që ne kemi parë në vende të tjera, ku kujdesi i politikave të strehimit është jo vetëm për këto kategori në nevojë, por edhe për shtresa të tjera, të cilat mund të kenë nevojë për mbështetje", u shpreh Ibrahimaj.

Ministrja vuri në dukje se përgjatë një viti MEI ka analizuar programet europiane të strehimit dhe, mbi bazën e modeleve të aplikuara në vende të ndryshme, janë hartuar propozimet për reformën, si në drejtim të produkteve të reja të strehimit, ashtu edhe të arkitekturës institucionale të AZHT-së që do të mbështesë zbatimin e tyre.

Përpara finalizimit të kuadrit ligjor, Ministria ka nisur konsultimin me aktorët e tregut për të vlerësuar ofertën konkrete të banesave që mund të përfshihen në skemat e reja të strehimit të përballeshëm.

"Para se të finalizojmë produktin ligjor që kemi punuar, donim ta diskutonim me ju, me qëllim analizimin e disponibilitetit të produkteve që ne synojmë të ndërtojmë", u shpreh ministrja, raporton Monitor.al.

Në këtë kuadër, një nga produktet e reja parashikon mbështetje për blerjen e apartamenteve përmes kredisë bankare, me trajtim të subvencionuar të normës së interesit. Për apartamentet me vlerë deri në 60 mijë euro, përfituesi do të marrë kredi me 0% interes, ndërsa për apartamentet me vlerë mbi 60 mijë euro, përfituesi do të përballojë interesin deri në 3%, me pjesën e normës mbi këtë nivel të subvencionuar nga shteti.

Lidhur me ofertën për apartamentet deri në 60 mijë euro, ministrja bëri të ditur se, nga konsultimet paraprake me Shoqatën e Ndërtuesve, është konfirmuar ekzistenca e apartamenteve me sipërfaqe të vogla dhe me çmime të përshtatshme në rrethinat e Tiranës.

"Ka pasur dhe debate, me pikëpyetje: a ka të disponueshme të tilla apartamente në qytetin e Tiranës? Në fakt, ne e prezantuam këtë pas diskutimeve që patëm me Shoqatën e Ndërtuesve, ku në rrethinat e Tiranës kemi marrë garanci që ekzistojnë të tilla apartamente që janë me sipërfaqe të ulëta dhe me një çmim të ulët", u shpreh ministrja.

Sipas ministres, reforma parashikon mbështetje për blerjen e apartamenteve edhe me vlerë mbi 60 mijë euro. Blerja do të mbulohet 100% përmes kredisë bankare, ndërsa shteti do të subvencionojë pjesën e normës së interesit mbi 3%. Kufiri maksimal i vlerës së apartamentit është ende në diskutim dhe orientimi është rreth 200 mijë euro. Kjo skemë i dedikohet të punësuarve që kanë nisur karrierën e tyre, si dhe çiftëve dhe familjeve të reja.

"Ne do të kemi limitin maksimal diku tek 200.000 euro dhe i dedikohet një kategorie tjetër, që janë të punësuar, që kanë filluar karrierën e tyre dhe ne duam t'i mbështesim", u shpreh Ibrahimaj.

Pjesë e politikës së re do të jetë edhe subvencionimi i qirasë për profesionistët dhe familjet e reja. Sipas propozimit, qiraja do të ketë një kufi deri në 500 euro, ndërsa qeveria do të mbulojë gjysmën e kësaj vlere.

"Ne duam që të fillojmë një politikë për subvencionimin e qirasë, e cila nuk do të ketë një kosto më të madhe se 500 euro, ku qeveria do të mbulojë gjysmën e kësaj vlere gjithashtu për profesionistët apo familjet e reja", tha ministrja.

Ministrja Ibrahimaj bëri të ditur se synimi është që këto skema të hapen në muajin nëntor, pas përfundimit të ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe akteve zbatuese.

Në kuadër të reformës, Agjencia e Zhvillimit të Territorit do të ridimensionohet për të marrë një rol më të plotë në zbatimin e politikave të strehimit dhe për integrimin e tyre me planifikimin territorial.

Sondazh

Lexo gjithashtu



🕒 E Mërkurë 17:34

8% e shqiptarëve nuk përballojnë dot ekzaminimet nga kostoja e shëndetit, e dyta më e lartë në Europë



Ekonomi

Hetimet dhe sekuestrimit e SPAK ulin kërkesën për apartamente, kush po blinte?!

🕒 E Martë 18:15



Ekonomi

Nga Viva Fresh te Albi Group e Vertex Holding, bizneset nga Kosova investuan 186.4 milionë euro vetëm vitin e kaluar në Shqipëri (SHIFRAT)

🕒 E Hënë 16:04



🕒 E Diel 16:49 Newsbomb

Kostoja e një foshnje në Shqipëri, e dyta më e shtrenjtë në Europë (SHIFRAT)






Ekonomi

Shqipëria paditet sërish në Arbitrazh, zbulohet fatura e Ministrisë së Kulturës: 800.000 euro paradhënie për gjyqin ndërkombëtar (FAKSIMILE)

E Shtunë 12:41



Ekonomi

Shqipëria ndër vendet me naftën më të shtrenjtë, kushton 2.6 herë më shumë se mesatarja e gjithë Europës

E Shtunë 08:12



E Premte 17:31


Administrata Doganore sqaron manualin e ri, ja si përlllogaritet vlera e zhdoganimit të makinave



Ekonomi

8 milionë euro për TRANSFORMIMIN e Durrësit, nga Ura e Dajlanit te godina e Kavalishencës, ja si do të duket qyteti bregdetar (PAMJE)

E Premte 11:32 Newsbomb



Ekonomi

Rikonstruksioni i rrugës Kombinat-Ndroq-Plepa, kompania "G.P.G" shpallet fituese e Lotit 3 me ofertë rreth 10 milionë euro

E Enjte 22:40



E Enjte 10:14 Newsbomb

Nafta në Shqipëri 70 lekë më shumë se në

rafon, komindustria kerkese qeverise. Ndërhyni për të vendosur kosto mesatare



Ekonomi

Tarifa e re për kriimin e rezervës së



Ekonomi

Nivell i dvtë më i ulët i të gjitha

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.